

## Filloi zbatimin projekti: “Mbështetja e mësuesve të ardhshëm në përdorimin e TIK në edukimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore”




*“Mbështetja e mësuesve të ardhshëm në përdorimin e TIK në edukimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore”.*

Në kuadër të iniciativës për promovimin e së drejtës për arsimit gjithëpërfshirës nga Universiteti “Marlin Batrleti” dhe “Instituti Shqiptar për Çështjet Publike”, mbështetur nga Ambasada Australiane, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” dhe universitetet “Luigj Gurakuqi”, “Fan S. Noli”, “Aleksandër Moisiu”, “Ismail Qemali dhe “Eqerem Çabej” janë pjesë e projektit

Ky projekt me shtrirje kombëtare përfshiu angazhimin e drejtëpërdrejtë të dymbëdhjetë pedagogëve dhe gjashtëdhjetë studentëve nga universitetet e mësipërme. Në datat 19 dhe 20 shtator, në ambientet e Universitetit “Fan S.Noli”, në Korçë u realizua trajnimi i parë intensiv i studentëve ku trajnerë ishin pedagogë profesionistë. Ky aktivitet u kthye në një mjedis të vërtetë të shkëmbimit të informacionit dhe eksperiencave midis pedagogëve dhe studentëve. Trajnimi u fokusua në tematikat e mëposhtme:

- Edukimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në Shqipëri.
- Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK), aksesibiliteti dhe procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- TIK dhe procesi mësimor për nxënës të që nuk shikojnë.
- TIK dhe procesi mësimor me nxënës që nuk dëgjojnë



Nga universiteti i Elbasanit u trajnuan njëmbëdhjetë studentë si edhe pedagogët Prof. As. Dr. Ardjan Turku dhe Prof. As. Dr. Roland Çerepi.

Studentët pjesëmarrës nga Fakulteti i Edukimit të Universitetit “A. Xhuvani”:

Studentë: Master Profesional në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor në Edukim Shëndetësor

1. Desara Korça
2. Oktaviana Bella
3. Leonarda Shqau
4. Kristi Mita
5. Erind Qosja

Studentë: Bachelor në Arsim Fillor

6. Valentina Rexhepi
7. Xhesika Shabani
8. Fatjona Shabani
9. Florina Balla
10. Ledina Hasani
11. Fjona Bici



Aktiviteti dhe qëndrimi në qytetin e Korçës veç përfitimit profesional përmbante edhe aktiviteteve sociale në të cilat u shkëmbyen eksperiencia dhe përvoja midis studentëve dhe pedagogëve të ardhur nga universitete e treva të ndryshme të vendit. Projekti ka kohëzgjatje një vit e gjysëm dhe do të pasohet me aktivitete të ngjashme.

Në fund të aktivitetit studentët u pajisën me certifikatë pjesëmarrjeje.